



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 4 maj 2015, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.
Mungoi, Puhie Demaku.

Pjesëmarrës të tjerë: Margarita Kadriu, deputete; Lumnije Murati, ZPRK; Sanije Berisha, OSBE; Gurjeta Zeka, LVV; Lekë Batalli, GLPS; Vlora Nushi, UNMIK/OPA; Shaban Selimi, DPMN i KRK dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më dt. 14 prill 2015;
3. Organizatat parlamentare ndërkombëtare;
4. Shqyrtimi i shkresës së MPJ-së;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më dt. 14 prill 2015

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur, më dt. 14 prill 2015.

3. Organizatat parlamentare ndërkombëtare

Enver Hoxhaj, i njoftoi anëtarët se nga takimi i Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës, njëra nga pikat e rezolutës, të cilat janë miratuar, ka qenë edhe ftesa e Parlamentit Evropian që Kuvendi i Kosovës të anëtarësohet në organizata të ndryshme rajonale, evropiane e ndërkombëtare. Kryetari njoftoi se Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e Kuvendit të Kosovës, e ka përgatitur një listë të organizatave ku Kuvendi duhet të anëtarësohet, duke cekur se Parlamenti Evropian, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe Asambleja Parlamentare e NATO-s, janë organizata ku Kuvendi mund të marrë pjesë si mysafir apo vëzhgues, mirëpo nuk mund të anëtarësohet, sepse Kosova nuk është anëtare e BE-së, e Këshillit të Evropës dhe e NATO-s.

Kosova, tha se ka arritur të anëtarësohet në Organizatën e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), pritet në takimin e radhës që Kuvendi i Kosovës të bëhet anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë.

Sa i përket organizatave, si Unioni Ndërparlamentar në Gjenevë, Forumi Parlamentar i Cetinës, Dimensioni Parlamentar për Iniciativën e Adriatikut – Jonit dhe organizatave tjera, tha se nuk jemi anëtar të këtyre organizatave.

Kryetari kërkoi nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, ta riorganizojë listën e organizatave, duke filluar prej organizatave rajonale, atyre të Evropës Juglindore dhe të kalohet pastaj në nivelin evropian dhe në atë ndërkombëtar. Mënyra e anëtarësimit të Kosovës në organizata rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare ndryshon, pasi që në rajon ne e kemi një marrëveshje, e cila rregullon anëtarësimin e Kosovës, ndërsa sa i përket nivelit evropian dhe ndërkombëtar, ne nuk kemi marrëveshje, por aplikojmë si shtet sovran dhe i pavarur.

Po ashtu tha se është në pritje të ftesës nga Kryesia e Kuvendit për ta njoftuar atë lidhur me këto organizata dhe shtoi se kjo listë do t'i përcillet edhe Kuvendit.

Ramush Haradinaj, tha se tani e kemi një pamje më të qartë të organizatave më të rëndësishme dhe kërkoi nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të identifikojë se, çfarë veprimesh duhet të ndërmerren që të ndodhë një avancim i marrëdhënieve tona me këto organizata.

Zafir Berisha, tha se bazuar në listën e ofruar, vërehet se ka ngecje në këtë drejtim nga vendi ynë. Më tej shtoi se ka ngecje edhe sa i përket formimit të grupeve të miqësisë nga Kuvendi i Kosovës, meqë nga vizita në Çeki, kemi ardhur në përfundim se pjesëmarrja ose prezenca e deputetëve në vende të caktuara, e ka rëndësinë e vet. Ngecja në krijimin e grupeve të miqësisë, ndoshta është një arsye e vogël pse ne nuk jemi azhur në integrimin në këto mekanizma. Kosova, edhe pse shtet i ri, tha se duhet t'i evidentojë pengesat dhe të gjinden format për tejkalimin e tyre.

Blerta Deliu-Kodra, tha se nga Samiti i Bukureshtit, Kosova e ka marrë të drejtën e statusit vëzhgues në SEECP, kurse pritet që në muajin maj ta ketë statusin e plotë me të drejtë vote, sipas një deklarate të përbashkët të shteteve anëtare të Asamblesë Parlamentare të shteteve të Evropës Juglindore.

Elmi Reçica, theksoi se tani kemi një material të organizatave ku Kuvendi dhe shteti ynë ka nevojë të jetë prezent. Duke u ndërlidhur me diskutimet e mëhershme, tha se është shumë me rëndësi që Kryesia të ftojë kryetarin e Komisionit në një takim, dhe nëse nuk e bën Kryesia, atëherë çështjen e anëtarësimit në organizata parlamentare mund ta prezantojmë në seancë plenare. Kërkoi nga Kryesia që t'i ofrojë Komisionit mbështetjen brenda kompetencave të veta dhe të përshpejtohet formimi i grupeve të miqësisë, duke shtuar se kur krijohet kontakti i drejtpërdrejtë, mund t'i sqarojmë ata që janë të dezinformuar.

Margarita Kadriu, vlerësoi se ky raport është një hap para dhe tregon që po ecim pozitivisht në rrugën e diplomacisë parlamentare. Propozoi të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit, që të mos lihet anash formimi i grupeve të miqësisë, meqë formimi i tyre është një çështje e rëndësishme.

Enver Hoxhaj, kërkoi nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e Kuvendit, që të bëjë riorganizimin e listës së organizatave parlamentare, duke përfshirë kohën e aplikimit për secilën organizatë, të bëhet dallim nëse aplikimi është akt apo proces i përmbushjes së kriterëve, apo standardeve të caktuara, të shikohen procedurat teknike dhe ligjore se a mund të anëtarësohemi në ndonjë organizatë pa qenë anëtar i OKB-së. Për secilën organizatë, të ketë një përshkrim të shkurtër, të nxirret bilanci i forcave brenda çdo organizate, sa vende e kanë njohur Kosovën, sa nuk e kanë njohur Kosovën dhe këto që e kanë njohur Kosovën, çfarë roli kanë. Sa i përket grupeve të miqësisë, tha se janë diku 12 deri në 13 shtete, që janë të gatshme të formojnë grupe të miqësisë dhe se është me rëndësi të kemi grupe të tilla të miqësisë

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e Kuvendit, të riorganizojë listën e organizatave parlamentare ndërkombëtare me këto elemente shtesë:

- *të bëhet riorganizimi i organizatave, duke filluar prej organizatave rajonale, organizatave të Evropës Juglindore, organizatave evropiane dhe ndërkombëtare;*
- *të ceket koha e aplikimit për secilën organizatë;*
- *të ceket nëse aplikimi është akt apo proces i përmbushjes së kriterëve të caktuara;*
- *të shikohen procedurat teknike dhe ligjore të aplikimit;*
- *të ketë një përshkrim të shkurtër për secilën organizatë;*
- *të nxirret bilanci i forcave brenda çdo organizate, sa vende e kanë njohur Kosovën dhe sa nuk e kanë njohur.*

4. Shqyrtimi i shkresës së MPJ-së

Enver Hoxhaj, theksoi se nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komisionit i është përcjellë propozimi për emërimin e dy kandidatëve për ambasadorë. Bazuar në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, Komisioni mban seanca të mbyllura dëgjimore për kandidatët e propozuar për të verifikuar plotësimin e kriterëve të caktuara në paragrafin 2 të nenit 6 dhe i raporton rezultatet e dëgjimeve në besim presidentit, kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme.

Kandidatët e propozuar për ambasadorë, janë Vlora Çitaku dhe Leon Malazogu.

Pas diskutimit të anëtarëve të Komisionit, lidhur me dëgjimin e kandidatëve të propozuar për ambasadorë, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kandidatja e propozuar për ambasadore në SHBA, Vlora Çitaku, të ftohet në seancë të mbyllur dëgjimore të Komisionit, të premten, më dt. 8 maj 2015, ndërsa kandidati i propozuar për ambasador në Japoni, Leon Malazogu, të martën, më dt. 12 maj 2015.

5. Të ndryshme

a) Anëtarët e Komisionit të cilët realizuan vizitën zyrtare në Çeki: Qerim Bajrami, Blerta Deliu- Kodra e Zafir Berisha, njoftuan Komisionin lidhur me vizitën. Ata theksuan se ka qenë një vizitë e frytshme, ngase deputetët dhe senatorët e Parlamentit të Çekisë janë njoftuar me progresin dhe të arriturat e shtetit të Kosovës.

Kryetari, i njoftoi anëtarët e Komisionit se pas vizitës së delegacionit në Çeki, i ka përcjellë letër falënderuese kryetarit të Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë dhe kryetarit të Komitetit për Çështje të Bashkimit Evropian të Parlamentit të Çekisë.

Anëtarët e Komisionit pyetën për përgjigje të Ministrit të Jashtëm, në ftesën e Komisionit për raportim, si dhe propozuan që të ftohet për të raportuar në Komision, ministri i MIE lidhur me procesin e liberalizimit të vizave dhe MSA-së.

Në propozim të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të ftohet për raportim në Komision, ministri i MIE, z. Bekim Çollaku lidhur me Marrëveshjen e Stabilizim- Asociimit dhe përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave.

b) Kryetari i Komisionit njoftoi se një grup i studentëve nga Holanda, dëshirojnë të takohen me deputetë të Komisionit për Punë të Jashtme dhe deputetë të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Ai i ftoi anëtarët e Komisionit që të marrin pjesë në këtë takim, i cili do të mbahet të premten, më dt. 8 maj 2015, në orën 10:00.

c) Lidhur me ftesat për vizita zyrtare, Komisioni vendosi që kjo çështje të shqyrtohet në njërën nga mbledhjet e ardhshme.

Komisionit vendosi që gjatë muajit maj apo qershor, të ftojnë deputetët nga Lugina e Preshevës me kryetarët e komunave, si dhe ata të Maqedonisë dhe Malit të Zi, në tri takime të veçanta, për t'i dëgjuar lidhur me pikëpamjet e tyre.

Po ashtu, Komisioni vendosi që deputeti Qerim Bajrami, së bashku me deputetët e tjerë të komunitetit boshnjak dhe anëtarë të tjerë të Komisionit, të iniciojnë realizimin e një vizite në Bosnje, për të diskutuar lidhur me heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës, drejt Bosnjës.

Lidhur me vizitën në Shqipëri, anëtarët e Komisionit propozuan që të shikohet mundësia e realizimit të vizitës, në kohën kur krerët e shtetit gjenden në vend.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Enver Hoxhaj